



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 11.01.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **03.01.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Pro Medical SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së"** Lot 10 dhe Lot 14 me numër prokurimi 206-23-4215-1-1-1 nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e operatorit ekonomik Pro Medical SH.P.K. e dt.03.01.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së" Lot 10 dhe Lot 14, me numër prokurimi 206-23-4215-1-1-1, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK, të datës 27.12.2023, të publikuar në platformën elektronike;
2. **Mbetet në fuqi**, Njoftimi mbi Vendimin e AK, i datës 27.12.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik Pro Medical SH.P.K. me datë 03.01.2024 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së" Lot 10 dhe Lot 14, me numër prokurimi 206-23-4215-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, sot me datë 11.01.2024, e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE Pro Medical SH.P.K.:

Aktivitet të prokurimit është në kundërshtim me Ligjit të Prokurimit Publik, nr.04/L-042 pra dispozitat e shkelura te LPP-se:

Neni 1- Qëllimi

Neni 7 Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik 40.

Pretendimet ankimore:

AK- Ministria e Shëndetësisë ne aktivitetin e prokurimit Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative te QKUK-së” LOTI 10, dhe LOT 14

AK ne aktivitetin e prokurimit te larteshenuar ka bere Njoffimin mbi Vendimin e AK-se me datën 27.12.2023 , ku LOT 10 është anuluar, kurse për LOT 14 ka shperblyer me kontrate OE “MEDITECH” në kundërshtim me LPP dhe Vendim e OSHP me nr 0671, lidhur me LOT 14 ku është konstatuar se ky OE është pa përgjegjshëm.

Neni 1- Qëllimi- E kundërshtojme vendimin e Autoritetit Kontraktues ngase i njefti eshte ne kundërshti me nenin 1 te Ligjit per Prokurim Publik dhe paragrafin nuk ka marre ne konsiderate detyrimin. AK në këtë rastin tonë ka shkelur Nenin 1 paragrafin 2 të LPP citim “Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”

Neni 7 Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi- Ky nene është parimi bazë i Prokurimit Publik, ku cekë se Autoriteti kontraktues duhet ti trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese , por ne kemi vërtur se nuk jemi trajtuar si barabartë nga AK ku ne vijm do paraqesim fakte dhe shëshmit gjithashtu edhe pretendimet tona anikmore.

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve- AK nuk ka respektuar LPP gjatë vlersimit të ofertës tonë.

Por AK ishte i obliguar të merrte parasysh Ligjin e Prokurimit Publik (LPP), përfshirë Nenin 72 dhe Nenin 59.2. Megjithatë, duke mos kërkuar informacion shtesë nga ju, ju keni bërë një vlerësim që në kundërshtim me LPP, dhe duke pasuar si qëllimin për eliminimin e ofertës tonë LOT 10.

Në këtë pikë, dëshirojmë të informojmë AK-në si vijon dhe arsyimet i eliminimit tonë është kundërshtime me parimet bazë LPP të cekur më lartë.

Lidhur me LOT 10 ne do të bëjmë arsytimin dhe do të argumentojm se paisja jonë i plotëson dhe tejkalon specifikacionet teknike të kërkuar nga AK apo NJK dhe oferta jonë është konfrom

sqarimeve te AK të dates 26.05.2023 pra pretendimet tone per LOT 10 do jenë të bazuar në dëshmi, fakte dhe prova relevante por AK duhet te ketë parasysh sqarime e dates 26.05.2023 si më poshtë:

LOTI 10, 12,14, 15,16 dhe LOT 18

Ne kemi vrejtur se specifikacionet per keto LOTO ne vecanti po thuj per te gjitha LOT jane vetem copy/past ku ne nje menyre jane ne kundershtime me LPP Neni 7 dhe Neni 28 sepse eshte favorzuar vetem nje prodhuesi i caktuar, dhe pyetja jone eshte si me poshte.

Pyetja 3 per AK dhe NJK

Ne kerkojm nga AK dhe NJK qe te mundeson OE te ofertojm me pasijet me secifikacione te peraferta por qe plotesojn qellimin e keti aktiviteti te prokurimit sepse siq jane tani jane vetem copy/past specifikacionet teknike, ku edhe kemi bere krahsimi ne mes DT dhe prodhuesit jane vetem copy/past, pra qe te mosfavorzohet prodhuesi e caktuar ne kerkojm qe te mundesoj OE te ofertoj me pasijet me peraferta.

Përgjigja në pyetjen 3 të OE 5:

Referojuni dosjes së tenderit. Specifikat e kërkuara në DT janë minimumi që kërkohet dhe plotësohen nga shumë prodhues. Pra, të pranueshme janë ofertat me specifikat e përshkruara në DT ose më të avansuara se këto (or better, or higher).

Pretendimi i pare ankimor për Lot 10 - Furnizim me pajisje mjekësorë për Kl. e Oftalmologjisë

Ne kemi vënë re sa komisioni vlersues ka bërë disa gabime/ devijimeve në vlerësimin e ofertës tonë, dhe dëshirojmë t'ju japim shpjegime të sakta dhe të plotësisht të qartësuar për arsyet e këtyre gabimeve nga komisioni vlersus ne jemi eliminuar edhe pse AK/NJK kanë thënë sqarime me datë 26.05.2023.

AK ne Leter Standarde per OE Eliminimuar 27.12.2023 është cekur arsyjet eliminimit si më poshtë per LOT 10.

Arsytimi i eliminimit me shumë nje arsytine fiktive dhe pa parsyshme dhe nuk ka paraqitur gjendje fakti dhe real pra dhe qëllin e kesaj paisje.

Oferta e Operatorit Ekonomik PRO MEDICAL SH.P.K. është e papërgjegjshme për Lotin 10 për këto arsye:

Klinika e Syve ka kërkuar me qëllim pajisje më të avancuar, pra, me dy sisteme të funksionimit, respektivisht me "joystick" dhe me "touch screen".

Pajisja me te cilin keni ofertuar për lot-in 10, e ka vetëm një sistem të funksionimit, atë me "touch screen". Andaj, me mungesën e sistemit të funksionimit me "Joystick" oferta juja për këtë Lot është e papërgjegjshme sepse nuk i plotëson specifikat teknike të kërkuara në dosje të tenderit.

Pajisja me dy sisteme të funksionimit për matje të tensionit intraokular non-kontakt, është më e avancuar në krahasim me pajisjet që e kanë vetëm një sistem të punës (vetëm me "joystick" ose vetëm me "touch screen").

Në rastet ideale, kur pacienti është i qetë, i përqendruar në ekzaminim dhe bashkëpunues, pa probleme për hapjen optimale të syrit, pa probleme me kapakët e lëshuar që e zvogëlojnë rimbën (hapësirën) e syrit për matje të tensionit intraokular, atëherë matja mund të bëhet me funksionin me "touch screen".

Por, në praktikën tonë kemi pacientë të moshave të ndryshme, fëmijë dhe të moshuar që nuk mund të qëndrojnë në mënyrën më optimale para aparatit për matje të tensionit, të shqetësuar, të papërqendruar për të kryer ekzaminim, pacientë me shikim të dobësuar, që lëvizin në mënyrë të pakontrolluar, pastaj pacientë me patologji të ndryshme të syrit ku duhet infermierja duhet me duar ta bëjë hapjen e kapakëve të pacientit për të mbajtur syrin e hapur ashtu si duhet për ekzaminim, e në të gjitha këto raste të sipërpërmendura ne bëjmë ekzaminim me përdorimin e "joystick"-ut i cili na mundëson që të ndjekim syrin e pacientit për të kryer ekzaminimin, matjen e tensionit intraokular.

Lidhur me këtë Çështje kemi kërkuar mendim profesional edhe nga Klinika e Syrit në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës me qëllim të vlerësimit sa me profesional, duke kërkuar mendim profesional nga drejtori i Klinikës së Syrit se a pajtohen apo nuk pajtoheni me konstatimin e anëtarëve të komisionit (Profesionistëve Shëndetësorë) dhe a mundet që kjo pajisje të shërbejë pa "joystick" në Klinika e Syrit ?

Drejtori i Klinikës së Syrit ka konfirmuar se pajtohet plotësisht me mendimin e profesionistëve Shëndetësorë dhe ka konfirmuar se kjo pajisje pa "joystick" nuk është e pranueshme për Klinikën e Syrit.

Po AK duhe të ketë parasysh DT dhe sqarimet e dhena e jo analiza dhe komentime lidhur me paisjen nga komisioni vlersuese, sepse është hera e parë që kemi vrejtur një konstatim nga komisioni vlersues dhe kjo ka krijuar dyshime se të gjitha LOTO që kanë qenë Kl e Oftalmologjisë janë fituar nga OE " MEDITECH" ku kemi vrejtur se të gjitha sepcifikacionet teknike në DT dhe paisjet e ofenuar nga OE " MEDITECH" janë identike që kjo ka krijuar dyshime se specifikacionet teknike janë bërë ndoshta në bashkëpunim me OE " MEDITECH" dhe Kl. e Oftalmologjisë.


Sa i përket konstatimit të komisionit nuk qëndrom dhe kjo nuk është e qëndrueshme për shkak se në sqarime keni dhene munesi të ofertohe me teknologji me të mire dhe avancuar.

Arsyetini juaj për nevojën e trajtimit manual të pacientëve për shkak të aplikimit të syve me joystick nuk është i qëndrueshëm. Duhet të përdorni teknologjinë e avancuar, e cila mundëson levizjen automatike të syrit dhe kokës. Prandaj, besoj se qëllimi është që të ofrojmë një klinësi dhe avancim të pajisjeve, dhe jo shfrytëzimin e pajisjeve manuale.


Tonometer automatik pa kontakt TonoVet Me teknikën e gjurmimit 3D, matje të shumta IOP mund të bëhen me një prekje të vetme.

Ndjekja automatike 3D pra gjurmimi automatik dhe shtrirja automatike me një trokitje të lehtë të bebëzës.

Besoj se komiioni e ka parasysh se koka vendoset në paisjet me poshte dhe e vendosur edhe në mjekre si pike reference ku në baze të levizjes së kokës, levize paisja në menyre automatike me 3D ose opcionin manual siq është cekur në foto më poshtë.




Opcioni me levizjes para, pas, lart dhe poshte po thuaj se me justik por vetëm me avancuar.



Arsyejet e eliminimit të tonë (Pro Medical) nga komisioni vlersues i AK nuk qëndron sepse në vijim do të argumentoj se arsya e eliminimit është i paarsyeshëm dhe i pa i bazuar për: Joystick Peratio ose Funksioni i levës (shqip).

Ne për LOT 10 me paisjen e ofertuar kemi plotësuar dhe tejkalluar kërkesa e AK pra NJK sepse kemi ofertuar me pajisjet shumë avancuar se sa kërkesat teknike në DT, pra ne kemi ofertuar me pajisje më të avansuara pra siq është cekur edhe në sqarime AK or better, or higher pra paisja jonë e ofertuar për LOT 10 pra Crystalvue TonoVue ka - Operim në formën Joystick nga ekrani siq kemi cekur më lartë, sepse pajisja është me një ekran prekës LCD 10.1 inç dhe të gjitha veprimet bëhen me një prekje të vetme në mënyre manual pra klasike apo automatike, pra paisja jonë është me e avancuar e cila të gjitha veprimet i kryen shumë thjesht dhe më precizitet të lartë, se me Operim me Joystick, si kemi theksuar me lart, pra paisja jone që kemi ofertuar është me e avancuar dhe të gjitha veprimet kryen vetëm në një mënyrë shumë të thjeshtë dhe të saktë, duke e bërë kështu Operimin me Joystick të panevojshëm, pra paisja jonë është Fully Automated Non-Contact ose shqip Plotësisht i automatizuar pa kontakt pra e teknologjia me të avancuar.

-Arsyejet e eliminimit të OE Pro Medical nga komisioni vlersues i AK nuk qëndron sepse në vijim do të argumentoj se arsya e eliminimit është i paarsyeshëm dhe i pa i bazuar. Ju lutem shikoni menyre e operim ne video e dorzuar ne Ankesë.



Duke i plotësuar dhe tejkeluar këto specifikacione teknike, parametra dhe duke marr parasysh këto performancat të teknologji më të avancuar, pajisja jonë ofron një performancë të jashtëzakonshme dhe ndryshon për më mirë sfidën e të kryerit të shërbimeve me pajisje të fundit teknologjike në këtë fushë. Me teknologjinë më të fundit, pajisja jonë ofron një performancë më të përparuar dhe e përmbush me lehtësi kërkesat e shërbimeve lidhur me paisjen ne LOT 10.

Në lidhje me LOT 10, paisja jona e ofertuara ka plotësuar dhe tejkeluar kërkesat e NJK dhe AK. Ne kemi ofertuar pajisje që janë shumë më të përparuara se kërkesat e përcaktuara në DT, kurse komisioni vlersues nuk e ka vlerësuar këtë përparësi dhe pse e ka bërë të ditur në sqarimet e tyre se pranohen paisjet me më mirë, ose më lart (better, or higher) pajisja jonë për LOT 10

Duke pasur parasysh këto përfitime të paisjeve të avancuara, kërkojmë nga AK/NJK që të kryejë një vlerësim profesional në përputhje me sqarimet e datës 26.05.2023 dhe të konsiderojë performancat më të përparuara që ofron paisja jonë. Ky vlerësim do të siguronte një përputhje të qartë midis avancimeve teknologjike dhe nevojave të interesit publik shendetësor.

Ne baze të dëshmive, provave dhe faktet ne si OE duhet të rekomandohemi per kontratë per LOT 10, kurse ju kemi Anuluar LOT 10 edhe pse ne kemi plotësuar specifikacione teknike dhe kemi tejkeluar ato.

Pretendimi i dytë ankimor për Lot 14 - Furnizim me pajisje mjekësore për Kl. e Oftalmologjisë
Ne si OE për LOT 14 nuk kemi pranuar nga AK LS me 21.08.2023 për tenderues të pasuksesshëm, por në bazë raportit të vlersimit ne jemi të pasuksesshëm kurse AK ka rekomanduar për kontrate OE " MEDITECH" për LOT 14 në kundërshtime me Neni 59 të LPP.

Kurse ne rivlersim neve ne elimonom me arsytim të cila janë në kundërshtime me sqarimet e dhena nga AK kurse te gjeturat ne raportit dhe vendimin e OSHP me numer protokollit Nr.671 nuk e merr edhe pse OE i rekomanduar nuk ka dorzuar fare katalogu per disa paisjet percellese.

Ne vendimin e pare te AK ne kemi qene te pasukseshshem (*cekur me poshte*) kurse ne vlersim AK na eliminim me arsytine te cilat vlen vetem per ne me arsytimin se mungoj edhe pse OE rekomandur i mungoj spcifikacionet teknike si: Sipas Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

1. Tavolinë e motorizuar, që i përshtatet lartësia e markës së njëjtë me rrota të vogla me frena, me këllëf paketimi (1), përshtatës elektrik (1) - 1 set
2. Karrige rrotulluese - 1 copë.
3. Karrige pacienti me përshtatje të lartësisë - 1 copë.
4. E pajisur me bateri që rimbushen - UPS: autonome ≥ 30 minuta

Por AK nuk vren kete tek OE rekomanduar sepse është favorizuar nga AK dhe NJK.


Oferta e juaj për lot-in 14. është e papërgjegjshme për Lot 14 për këto arsye:

Nuk i plotësoni kriteret teknike të kërkuara në dosjen e tenderit, andaj konsiderohet i papërgjegjshëm.


Në katalogun e ofruar për pajisjen e kërkuar, mungojnë këto karakteristika teknike, si vijon: mungon Vertex distanca prej 10 mm si dhe mungon Fog control.

Sa i perket siq keni cekur ju Vertex distance prej 10 mm ju e jeni ne dijeni se nje paramater i till nuk ka ndonje rendesi kurcial si duke marr parasysh se ka distancat tjera standarte tjera, por ju duhet te keni parasysh se OE i rekomanduar nuk ka te cekur as cilin model ka ofertuar edhe pse kriter ka qene ne DT si "Kërkesa 2. Operatori ekonomik te prezantoj katalogun (broshurën) e pajisjeve te ofruara dhe te nenvizohen ne menyre te qarte produktet dhe specifikat teknike te ofruara. Nëse ofrohet broshura, duhet te specifikohet linku i veb faqes"

Kurse OE i rekomanduar ka ofertua me dy model me poshte edhe duke mos e perfslure as paisjet percejllse sipas Aneksin 1.



Kurse je keni cekur se mungon Fog control por pasije jone kete e ke ne menyre ku ndryshohet ky opcion shiko me posht Fog control por pasije jone kete e ke ne menyre ku ndryshohet ky opcion shiko me poshtë pra na manual i perdorimit eshte kjo foto:



[How to change Setting Items]

Press one button on the left side of display.

[How to Change the Item]

Pressing any button on display yields the selection of related item.

[How to Change the Contents]

Press any un-pressed button on display. The selected button will be displayed in pressed button and the content will be changed.

NOTE: There are some contents to be changed in the other way. And such procedures will be instructed under the description of each item.

[How to Enter the Measurement Mode]

Press EXIT button to quit the SETUP mode and enter the Measurement mode.

[Items for REF]

- VD Vertex distance
- CYL Cylinder form
- INC-R Increment of sphere and cylinder
- D-SFT Diopter Shift of Sphere
Press INC or DEC button to change the value of sphere by 0.12.
- S-SPD Adjustment for Fogging speed
- P-SET Value Shift of Pupil Distance
Press INC or DEC button to change the value of Pupil Distance.

Neni 59 Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve- AK nuk ka respektuar LPP gjatë vlersimit të ofertës të OE të rekomanduar për kontratë , në vijim do ilustrojm se pse ky OE duhet të eliminuar dhe jo rekomanduar për kontratë siç ka vepruar AK.

Specifikacionet teknike dhe kërkesat e AK për LOT 14 kanë qenë cekura si më poshtë:

LOTI 14- AUTO-KERATO-REFRAKTOMETËR - UPS, TAVOLINË E MOTORIZUAR, KARRIGE PËR KONTROLLUESIN DHE PACIENTIN - 5 copë.

Sipas Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Aksesorë

5. Tavolinë e motorizuar, që i përshtatet lartësia e markës së njëjtë me rrota të vogla me frenë, me këllëf paketimi (1), përshtatës elektrik (1) - 1 set
6. Karrige rrotulluese - 1 copë.
7. Karrige pacienti me përshatje të lartësisë - 1 copë.
8. E pajisur me bateri që rimbushen - UPS: autonome ≥ 30 minuta

Kurse OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorzuar për Aksorë asnje katalogu, specifikacion teknik, foto apo ndonje dëshmi se çfara (pozicioni 1) tavoline ka ofertuar elektrike / mekanike / manual, (pozicioni 2 dhe 3) çfarë karriga dhe çfarë (pozicioni 4) UPS , por ka dorzuar vetëm një deklarata e cila nuk mund të merr për bazë nga AK sepse deklarata nuk mund te zavendsoj katalogu apo specifikacionet teknike në rastin konkret, pra deklarate mund te pranohet vetem ne rastin konkrete si më poshtë ju lutem shikoni A02 Udhezues Nr-001 2023 per prokurimin publik, pra OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorzuar asnje informcion, katalog,specifikacione teknike, foto etj pra komisioni vlersues ka bërë vlersim shabllon pra pasur asnje ide se çfare aksesore do të dorzoj kurse AK dhe NJK duhet te ketë parasysh se këto kanë kosto financiare ku ky këto aksesore kane vlerë deri 2,000 deri 2,400. Euro set kurse 5 copa x 2,000 euro(min) =10,000 euro min me çmimi minimal.

<p>Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu ("specifikimit teknik" - AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzoj specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Përveç ne raste kur OE nuk mund të dorëzoj specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/ përime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do të jene ne përputhje</p>	<p>Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm</p>	<p>28</p>
---	--	-----------

Pra OE i rekomanduar për kontratë për LOT 14 është ne kundërshtime me Neni 59.4 citim

"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"

Rregullores 01/2022 per Prokurim Publik 40.2 citim " Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do t'i jepet

tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”

Edhe **40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:**

- a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;
- b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;
- c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.

Pra siq kemi cekur me lart dhe ne bazë LPP Neni 59.4 , Rregullores 01/2022 per Prokurim Publik 40.2 dhe A02 Udhezues Nr-001 2023 per prokurimin publik duhet të eliminuar nga AK e jo të rekomandohet për kontrata, dhe një herit AK duke e rekomanduar për kontratë këtë OE bie ndesh me Neni 7 të LPP sepse vrehet se ne jemi diskriminuar si ne LOT 10, LOT 14 dhe LOT 18.

Vlen të theksohet se gjatë ezaminimit dhe vlerësimit të ofertave, kemi vënë re se të gjitha specifikacionet teknike ishin identike me ato të ofruesit të produkteve "MEDITECH". Kjo ngre dyshime se në procesin e përgatitjes të specifikacioneve nga NJK ka favorizuar OE "MEDITECH" ku dhe pjesën dermuesë është edhe rekomanduar për kontratë.

Ne baze të dëshmiave, provave dhe faktet ne si OE duhet të rekomandohemi per kontratë per LOT 14, kurse OE i rekomanduar duhet të eliminohet sepse ka ofertuar dhe nuk ka dorzuar fare katalogu, specifikaionet teknike apo ndonje foto per Akcesore e kërkuara në Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

VENDIMI

- I. APROVOHET si e bazuar kerkesa per rishqyrtim dhe lenda te kthehet ne
- II. RIVLERESIM, dhe gjate fazes se rivleresimit AK te merr parasysh sqarimet tona per LOT 10,14 dhe LOT 18.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzimet për ankesa dhe humbje financiare të planifikuara

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore te OE për Lot 10:

Profesionistet shëndetësor nga Klinika e Oftalmologjisë, pas shqyrtimit te pretendimeve tuaja ankimore, kane konstatuar se pretendimet tuaja ankimore janë te pa bazuara dhe se oferta juaj nuk i plotëson specifikat teknike te kërkuara ne Dosje te Tenderit, për pikat si ne vijim:

Pika 4 – Funksionimi i levës është kërkuar (me Joystick) – Nuk e keni ofruar fare.

Pika 9 – Monitori nuk ka rrotullim majtas 20 – 30 shkalle, si dhe pjerrësi vertikale 30 – 40 shkalle. Ekрани i ofruar është fiks, i pa lëvizshëm.

Pika 7 – Nuk e keni ofruar Softuer me përditësime të pakufizuara dhe antivirus me përditësime të pakufizuara. Nuk keni ofruar asnjë deklaram për përditësimet e kërkuara ne tender.

Ekрани i ofruar nga ana juaj është pa ngjyra (bardh e zi) ndërsa ne specifikacion te tenderit është kërkuar **LCD me ngjyra**.


Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore te OE për Lot 14:

Profesionistet shëndetësor nga Klinika e Oftalmologjisë, pas shqyrtimit te pretendimeve tuaja ankimore, kane konstatuar se pretendimet tuaja ankimore janë te pa bazuara dhe se oferta juaj nuk i plotëson specifikat teknike te kërkuara ne Dosje te Tenderit, për pikat si ne vijim:


Pajisja e ofruar nuk e posedon specifikën **Vertex distanca prej 10mm**, e cila ka qene kërkesë e DT - pika 9. Sa i përket pretendimit tuaj ku keni cekur se Vertex distance prej 10 mm nuk ka ndonjë rendësi kruciale, ky pretendim është plotësash i pa bazuar, sepse ne aspektin profesional kjo specifike e kërkuar ka rendësi shumë te madhe te matjet e dioptrive te mëdha, për shkak te saktësisë se matjes.

Sa i përket specifikes **Fog control** qe pretendoni se e keni plotësuar, ne katalogun e ofruar nga ana juaj nuk vërehet një specifike e tille, katalogu nuk ka qartësi për tu vërejtur kjo specifike, si dhe nuk është e specifikuar as tekstualisht as ne tebele kjo komponentë ne katalog.


Gjithashtu fotografia e prezantuar ne ankesën tuaj nuk korrespondon me fotografimin e katalogut te ofertës, shih më poshtë fotografia ne ankesë:




Dhe fotografia ne katalogun e ofertës tuaj:



Display Mode



Setup Mode



[How to change Setting Items]

Press one button on the left side of display.

[How to Change the Item]

Pressing any button on display yields the selection of related item.

[How to Change the Contents]

Press any un-pressed button on display. The selected button will be displayed in pressed button and the content will be changed.

NOTE: There are some contents to be changed in the other way. And such procedures will be instructed under the description of each item.

[How to Enter the Measurement Mode]

Press EXIT button to quit the SETUP mode and enter the Measurement mode.

[Items for REF]

VD Vertex distance

CYL Cylinder form

INC-R Increment of sphere and cylinder

D-SFT Diopter Shift of Sphere

S-SPD Adjustment for Fogging speed

OFFSET Value Shift of Pupil Distance

Press INC or DEC button to change the value of sphere by 0.12.
Press INC or DEC button to change the value of Pupil Distance.

Gjithashtu teksti i me sipërm i ofruar ne ankesën tuaj, nuk ekziston ne katalogun e ofruar ne tender.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. Pro Medical SHPK
2. Operatoreve ekonomik te interesuar


Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit